

NE EMER TE PUPOLLIT

GJYKATA E QARKUT NE PRISHTINE ne Trupin Gjykses te përbëre nga Gjyqtari i EULEX-it Jonathan Welford-Carroll, Kryetar i Trupit Gjykses, Gjyqtarja Shqipe Qerimi, dhe Gjyqtari i EULEX-it Dean Pineles, anëtar te Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore te EULEX-it Zane Ratniece dhe Beti Hohler, si procesmbajtës, ne lenden penale kundër:

- I. **Arben KRASNIQI**, emri i babës , emri i nënës , i lindur me , ne , , me vendbanim ne , e ka kompletuar , ; i akuzuar sipas Aktakuzës se Prokurorit Special te EULEX-it PPS nr. 07/10, e datuar dhe e parashtruar ne Sekretari te Gjykates se Qarkut ne Prishtine me 25.07.2011 (Aktakuza), me veprat penale:

Akuza 1: Krime te luftës kundër popullatës civile dhe te burgosurve te luftës, sipas nenit 142, 144 te Kodit Penal te Republikës Socialiste Federative te Jugosllavisë (KPRSFJ) gjithashtu e parapare ne Nenin 120, 121 te Kodit Penal te Kosoves (KPK), i lexuar me Nenet 22, 24, 26 te KPRSFJ dhe 23, 25, 26 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës se IV te Gjenevës te vitit 1949, dhe Nenet 4, 5(1) te Protokollit Shtese II te Konventës se IV te Gjenevës (APII); i akuzuari ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se ne bashkëkryerje me Fatmir LIMAJ, Naser KRASNIQI, Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Behlul LIMAJ, Besim SHURDHAI, Sabit SHALA, dëshmitarin bashkëpunues X, Shaban SHALA dhe ushtarë te tjerë te UCK-se te pidentifikuar gjer me tani, e ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një numri te padefinuar te Serbeve dhe Shqiptareve civil dhe te burgosurve ushtarak Serb , te burgosur ne qendrën e improvizuar te burgimit ne fshatin Kleçke, duke i mbajtur ata ne kushte çnjerëzore (duke përfshire te burgosurit e lidhur me zinxhirë, ne lokale jo te duhura, ne te ftohte te tepërt, mungese te higjienës, ushqim jo adekuat, rrahje te shpeshta) ne Kleçke, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri ne mes te Qershorit 1999;

Akuza 2: Krime te Luftës Kundër te Burgosurve te Luftës, sipas Nenit 22, 144 te KPRSFJ , aktualisht i penalizuar sipas Nenit 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës te vitit 1949 dhe Neneve 4, 5(1) APII; i akuzuari ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se, ne bashke-kryerje me Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Refki MAZREKU, Naser KRASNIQI dhe me dëshmitarin bashkëpunues X ka marre pjese ne vrasjen e ushtareve te burgosur Serb, te mbajtur ne qendrën e

burgimit ne Kleçke, dhe mbetjet trupore te cilëve janë gjetur ne një varreze masive afër Kleçkës ku janë gjetur pese trupa; me saktësisht, i pandehuri ka marre pjese ne krime duke ia dhenë një kose Naser Shalës, kryesit kryesor te vrasjes, edhe pse ai e ka ditur, sepse ne mënyre eksplicite eshte informuar për qëllimet e Naser SHALA, qe ky i fundit do ta vriste te burgosurin me kose; ne Kleçke, Komuna e Lipjanit, ne një date te papërcaktuar ne Prill 1999, e jo para 11 Prill 1999;

Ku Akuza 2 eshte tërhequr nga Prokurori Special i EULEX-it ne tërheqjen e pjeserishme te Aktakuzës, te datës 09.11.2011, te parashtruar me 11.11. 2011, siç eshte prezantuar ne seancën e datës 11.11.2011;

Akuza 3: Krime te Luftës, nen nenin 22, 144 te KPRSFJ, e penalizuar nen Nenin 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës te vitit 1949 dhe nenin 4, 5(1) APII; i akuzuari ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se ne bashke-kryerje me Fatmir LIMAJ, Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Naser KRASNIQI, Behlul LIMAJ dhe dëshmitarin bashkëpunues X, ka marre pjese ne vrasjen e **Nejbojša Djuričić dhe Veljko Marković, dy oficerëve Serb te burgosur** ne qendrën mbajtëse ne Kleçke, te cilët janë ekzekutuar nga dëshmitari bashkëpunues X me disa te shtëna me arme dore; me saktësisht, i pandehuri ka marre pjese ne krim duke i bere te marshojnë te dy te burgosurit deri ne vendin e ekzekutimit dhe duke i mbajtur viktimat drejtpërdrejte ne duart e kryesit te ekzekutimit, edhe pse ai e ka ditur (sepse eshte informuar ne mënyre eksplicite për urdhrat e Fatmir Limaj), apo se paku ka mundur lehte te parasheh nga urdhrat e marre (duke i bere te burgosurit Serb te marshojnë ne një vend te largët ne pyll) se çka do ti ndodhte atyre; ne vendin e quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, Komuna e Lipjanit, me apo rreth datës 04/05 Prill 1999;

II. **Behlul LIMAJ**, emri i babës _____, emri i nënës _____, i lindur me _____, ne fshatin _____, me vendbanim ne fshatin _____, e ka kompletuar _____, i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1: Krime te luftës kundër popullatës civile dhe te Burgosurve te luftës, nen Nenin 22, 142, 144 te KPRSFJ, aktualisht i penalizuar nen nenin 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949 dhe Nenit 4, 5(1) te APII; i akuzuari, ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se ne bashke-kryerje me Fatmir LIMAJ, Naser KRASNIQI, Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Arben KRASNIQI, Besim SHURDHAI, Sabit SHALA, dëshmitarin bashkëpunues X, Shaban SHALA dhe ushtarë tjerë te paidentifikuar, e ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një numri te paidentifikuar te civileve Serb dhe Shqiptar dhe ushtarëve te burgosur Serb, te burgosur ne qendrën e burgimit ne Kleçke, duke i mbajtur ata ne kushte çnjerëzore (duke përfshire te burgosurit e lidhur ne zinxhirë, lokale jo te duhura, te ftohte te

tepërt, mungese te pastërtisë, ushqim te pamjaftueshëm, rrahje te shpeshta); ne Kleçke, Komuna e Lipjanit, nga koha e hershme e vitit 1999 deri ne mes te Qershorit 1999;

Akuza 2: Krime te Luftës Kundër te Burgosurve te Luftës, sipas Nenit 22, 144 te KPRSFJ , aktualisht i penalizuar sipas Nenit 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) te APII; i akuzuari ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se ne bashke-kryerje me Fatmir LIMAJ, Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Naser KRASNIQI, Arben KRASNIQI dhe dëshmitarin bashkepunues X, ka marre pjese ne vrasjen e **Nejbojša Djurićić dhe Veljko Marković, dy Oficere Police, te mbajtur ne qendrën e burgimit ne Kleçke**, te cilët ishin ekzekutuar nga dëshmitari X me disa te shtëna nga arma e dorës; me saktësisht, i pandehuri ka marre pjese ne krim duke i marshuar te burgosurit deri te vendi i ekzekutimit dhe duke i mbajtur viktimat drejtpërdrejt ne disponim te kryesit te ekzekutimit, edhe pse ai e ka ditur (sepse ne mënyre eksplicite eshte informuar nga urdhrat e Fatmir LIMAJ), apo se paku ka mundur te parasheh nga urdhrat e marre (duke i marshuar dy te burgosurit Serb ne një vend te largët ne pyll) se çka do t'ju ndodhte atyre; ne një lokacion te njohur si Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, me apo rreth 04/05 Prill 1999;

III. **Refki MAZRREKU**, nofka , emri i babës , emri i nënës , i lindur me , ne , me vendbanim ne , e ka te kryer , ; i akuzuar sipas aktakuzës me veprat penale;

Akuza 1: Krime te Luftës kundër popullatës civile, nen Nenin 22, 142 te KPRSFJ, aktualisht i penalizuar nen Nenin 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949, dhe Neneve 4, 5(1) te APII; i akuzuari, ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se, ne bashke-kryerje me Naser KRASNIQI, Nexhmi KRASNIQI dhe Naser SHALA, e kane vrare **Arben Avdylin**, civil Kosovar Shqiptar i cili me pare ishte burgosur ne, dhe i liruar nga qendra e burgimit ne Kleçke; me saktësisht, i pandehuri ka marre pjese ne krim duke mbajtur viktimën ne disponim te autoreve te veprës penale dhe duke e shtyre atë ne një grope ne toke ku me vone eshte ekzekutuar nga Naser KRASNIQI dhe Nexhmi KRASNIQI me një arme zjarri AK-47; ne Kleçke, Komuna e Lipjanit, me apo rreth 03/04 Prill 1999;

Akuza 2: Krime te Luftës Kundër te Burgosurve te Luftës, sipas Nenit 22, 144 te KPRSFJ , aktualisht i penalizuar sipas Nenit 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) te APII; i akuzuari ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se, ne bashke-kryerje me Naser KRASNIQI, Naser SHALA, Nexhmi KRASNIQI, Arben KRASNIQI dhe dëshmitarin bashkëpunues X ka marre pjese ne vrasjen e te burgosurit ushtarak Serb; ne mënyre me precize, i pandehuri

ka marre pjese ne krim duke e marshuar te burgosurin ne vendin e ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë ne disponim te drejtpërdrejte te autorit te veprës, Naser SHALA, edhe pse ai e ka ditur, sepse ne mënyre eksplicite eshte informuar rreth qëllimeve te Naser SHALES për te vrare te burgosurin nga biseda e mëparshme ndërmjet te fundit dhe Fatmir LIMAJ, se i burgosuri do te ekzekutohej; Ne Kleçke, Komuna e Lipjanit ne një date te papërcaktuar ne Prill, jo para 11 Prill 1999;

IV. **Sabit SHALA**, nofka ' , emri i babës , emri i nënës , i lindur me , ne fshatin , Komuna e , me vendbanim ne fshatin , Komuna e , e ka kompletuar shkollën ; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza1: Krime te luftës kundër popullatës civile dhe te Burgosurve te luftës, nen Nenet 22, 142, 144 te KPRSFJ, aktualisht i penalizuar nen nenin 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949 dhe Nenit 4, 5(1) te APII; I akuzuari, ne cilësinë e anëtarit te UCK-se, ne bashke-kryerje Fatmir LIMAJ, Naser KRASNIQI, Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Arben KRASNIQI, Behlul LIMAJ, Besim SHURDHAJ, dëshmitarin bashkëpunues X, Shaban SHALA dhe me ushtare tjerë te UCK-se te paidentifikuar gjer me tani, e ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një numri te paidentifikuar te Serbeve dhe Shqiptareve civil dhe te burgosurve ushtarak Serb, te mbajtur ne qendrën e burgut ne Kleçke, duke i mbajtur ata ne kushte çnjerëzore (duke përfshire te burgosurit e lidhur me zinxhirë, lokale jo te duhura, te ftohte te tepërt, mungese te pastërtisë, ushqim te pamjaftueshëm, rrahje te shpeshta); ne Kleçke, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i 1999 deri ne mes te Qershorit 1999;

Akuza 2: Krime te Luftës kundër te burgosurve te Luftës, sipas Nenit 22, 144 te KPRSFJ , aktualisht i penalizuar sipas Nenit 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) te APII; i akuzuari ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se dhe ne bashke-kryerje me dëshmitarin X, Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Besim SHURDHAJ, i kane torturuar katër te burgosur ushtarak Serb, te mbajtur ne qendrën e burgimit ne Kleçke, mbetjet trupore te te cilëve janë gjetur ne një varreze masive afër Kleçkës dhe se paku tre nga ata janë identifikuar përmes AND-se si Bojan Cvetković, Zarko Filipović dhe Zivota Todorović, duke i rrahur ata vazhdimisht, ne një date te papërcaktuar ne Prill 1999, jo para 11 Prill 1999;

V. **Shaban SHALA**, emri i babës , emri i nënës , i lindur me , ne fshatin , Komuna e , me vendbanim ne fshatin , Komuna e , e ka te kryer shkollën ; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1: Krome te luftës kundër popullatës civile dhe te Burgosurve te luftës, nen Nenet 22, 142, 144 te KPRSFJ, aktualisht i penalizuar nen nenin 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949 dhe Nenit 4, 5(1) te APII; I akuzuari, ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se ne bashke-kryerje me Fatmir LIMAJ, Naser KRASNIQI, Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Arben KRASNIQI, Behlul LIMAJ, Besim SHURDHAI, Sabit SHALA, dëshmitarin bashkëpunues X, dhe me ushtare tjerë te te UCK-se te paidentifikuar deri me tani, e kane shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një numri te padefinuar te ushtareve te burgosur Serb, te mbajtur ne qendrën e burgimit ne Kleçke, duke i mbajtur ata ne kushte çnjerëzore (duke përfshire te burgosurit e lidhur me zinxhirë, ne lokale jo te duhura, ne te ftohte te tepërt, mungese te higjienës, ushqim jo adekuat, rrahje te shpeshta) ne Kleçke, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri ne mes te Qershorit 1999;

VI. **Besim SHURDHAI**, emri i babës , emri i nënës , i lindur me , ne fshatin , me vendbanim ne , ; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale;

Akuza 1: Krome te luftës kundër popullatës civile dhe te Burgosurve te Luftës, nen Nenet 22, 142, 144 te KPRSFJ, aktualisht i penalizuar nen nenin 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949 dhe Nenit 4, 5(1) te APII; I akuzuari, ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se, ne bashke-kryerje me Fatmir LIMAJ, Naser KRASNIQI, Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA, Arben KRASNIQI, Behlul LIMAJ, Sabit SHALA, dëshmitarin bashkëpunues X, Shaban SHALA dhe ushtare tjerë te paidentifikuar te UCK-se, e kane shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një numri te padefinuar te civileve Serb dhe Shqiptar dhe te burgosurve ushtarak Serb, te mbajtur ne qendrën e burgimit ne Kleçke, duke i mbajtur ata ne kushte çnjerëzore (duke përfshire te burgosurit e lidhur me zinxhirë, ne lokale jo te duhura, ne te ftohte te tepërt, mungese te higjienës, ushqim jo adekuat, rrahje te shpeshta) ne Kleçke, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri ne mes te Qershorit 1999;

Akuza 2: Krome te Luftës kundër te burgosurve te Luftës, sipas Nenit 22, 144 te KPRSFJ , aktualisht i penalizuar sipas Nenit 23, 120 te KPK, ne shkelje te Nenit te Përbashkët 3 te Konventës IV te Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) te APII; i akuzuari ne cilësinë e tij si anëtar i UCK-se ne bashke-kryerje me Nexhmi KRASNIQI, Naser SHALA dhe Sabit SHALA i kane torturuar katër ushtare te burgosur Serb, te mbajtur

ne qendrën e burgimit ne Kleçke, mbetjet trupore te te cilëve janë gjetur ne një varreze masive afër Kleçke dhe se paku tre nga ata janë identifikuar përmes AND-se si Bojan Cvetković, Zarko Filipović dhe Zivota Todorović, duke i rrahur ata vazhdimisht; Ne Kleçke, Komuna e Lipjanit, ne një date te papërcaktuar ne Prill 1999, jo para 11 Prill 1999;

Pas mbajtjes se Shqyrtimit Kryesor te hapur për publikun me 11 dhe 14 Nentor 2011, 01 dhe 14 Dhjetor 2011, 16, 30 dhe 31 Janar 2012, 06, 07, 09, 28 dhe 29 Shkurt 2012, 01, 05, 06, 07 dhe 21 Mars 2012; te gjitha te mbajtura ne prezence te te akuzuarit Arben KRASNIQI, Avokates Mbrojtëse te tij Fehmije Gashi-Bytyqi, te akuzuarit Behlul LIMAJ, Avokatit te tij Mbrojtës Ramiz Krasniqi, te Akuzuarit Refki Mazrreku, Avokatit Mbrojtës te tij Haxhi Millaku, te Akuzuarit Sabit Shala, Avokatit Mbrojtës te tij Mexhid Syla, te Akuzuarit Shaban Shala, Avokatit Mbrojtës te tij Destan Rukiqi, te Akuzuarit Besim Shurdhaj, Avokatit Mbrojtës te tij Qerim Zogaj, me pare Fazli Balaj; përveç për seancat kur Avokati Mbrojtës i ka dërguar zëvendësimet ;¹ dhe ne prezence te Prokurorit Special te EULEX-it Maurizio Salustro nga Zyra e Prokurorisë Speciale te Kosoves;

PAS pleqnimit dhe votimit te mbajtur me 30 Mars 2012;

SIPAS Nenit 392 te Kodit te Procedurës Penale te Kosoves (KPPK) ne këtë dite te datës 30 Mars 2012, ne seance te hapur gjyqësore ne prezence te te gjithë te akuzuarve dhe Avokateve Mbrojtës te tyre dhe Prokurorit Special te EULEX-it Charles Hardaway, zëvendësues i Prokurorit Special te EULEX-it Maurizio Salustro;

Shpalle këtë

AKTGJYKIM

¹ Seancat e Shqyrtimit Kryesor janë mbajtur gjithashtu ne prezence te te akuzuarve dhe Avokateve Mbrojtës lënda e te cilëve eshte ndare.

- I. **Arben KRASNIQI**, me detalet e tij personale si me lart, i arrestuar ne Zvicër ne me qellim te ekstradimit me 16 Mars 2011, ne arrest shtëpiak nga 14 Prill 2011 deri me 21 Mars 2012, shpallet si ne vijim:

Sipas Nenit 390 3) KPPK

Akuza 1: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër Popullatës Civile dhe te Burgosurve te Luftës (ne shkelje te integritetit trupor dhe shëndetit te një numri te padefinuar te civileve Serb dhe Shqiptar dhe te burgosurve ushtarak Serb)

Akuza 3: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër te Burgosurve te Luftës, (pjesëmarrje ne vrasjen e Nejbojša Djurićić dhe Veljko Marković, dy oficereve te policisë Serbe)

Sipas Nenit 389 1) KPPK

Akuza 2: **REFUZOHET** Krime te Luftës kundër te Burgosurve te Luftës (pjesëmarrje ne vrasjen e te burgosurve ushtarak Serb)

- II. **Behlul LIMAJ**, me detalet personale si me lart, ne arrest shtëpiak nga 16 Mars 2011 deri me 21 Mars 2012, shpallet si ne vijim:

Sipas Nenit 390 3) KPPK

Akuza 1: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër te Burgosurve te Luftës, (ne shkelje te integritetit trupor dhe shëndetit te një numri te padefinuar te civileve Serb dhe Shqiptar dhe te burgosurve ushtarak Serb)

Akuza 2: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër te Burgosurve te Luftës, (pjesëmarrje ne vrasjen e Nejbojša Djurićić dhe Veljko Marković, dy oficereve te policisë Serbe)

- III. **Refki MAZREKU**, me detalet personale si me lart, i burgosur nga 16 Mars 2011 deri me 11 Korrik 2011 dhe ne arrest shtëpiak nga 21 Mars 2012, shpallet si ne vijim:

Sipas Nenit 390 3) KPPK

Akuza 1: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër te Burgosurve te Luftës (për vrasjen e Arben Avdylit)

Akuza 2: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër te Burgosurve te Luftës (pjesëmarrje ne vrasjen e një te burgosuri ushtarak Serb)

IV. Sabit SHALA, me detalet personale si me lart, ne burgim nga 16 Mars 2011 deri me 21 Mars 2012, shpallet si ne vijim:

Sipas Nenit 390 3) KPPK

Akuza 1: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër Popullatës Civile dhe te Burgosurve te Luftës (ne shkelje te integritetit trupor dhe shëndetit te një numri te padefinuar te civileve Serb dhe Shqiptar dhe te burgosurve ushtarak Serb)

Akuza 2: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër te Burgosurve te Luftës (torturimi i katër te burgosurve ushtarak Serb)

V. Shaban SHALA, me detalet personale si me lart, nen masën e paraqitjes ne stacion te policisë nga 16 Mars 2011 deri me 21 Mars 2012, shpallet si ne vijim:

Sipas Nenit 390 3) KPPK

Akuza 1: **JO FAJTOR** për Krime te Luftës kundër Popullatës Civile dhe te Burgosurve te Luftës (ne shkelje te integritetit trupor dhe shëndetit te një numri te padefinuar te civileve Serb dhe Shqiptar dhe te burgosurve ushtarak Serb)

VI. Besim SHURDHAJ, me personale si me lart, nen arrest shtëpiak nga 16 Mars 2011 deri me 21 Mars 2012, shpallet si ne vijim:

Sipas Nenit 390 3) KPPK

Akuza 1: **JO FAJTOR** për Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe të Burgosurve të Luftës (në shkelje të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të padefinuar të civileve Serb dhe Shqiptar dhe të burgosurve ushtarak Serb)

Akuza 2: **JO FAJTOR** për Krime të Luftës kundër të Burgosurve të Luftës (torturimi i katër të burgosurve ushtarak Serb)

SHPENZIMET E PROCEDURAVE PENALE

Sipas Nenit 103 (1) KPPK shpenzimet për procedurat penale sipas Nenit 99 (2) 1) deri 5) KPPK, shpenzimet e duhura të pandehurit dhe kompensimi dhe shpenzimet e duhura të avokateve mbrojtës, si dhe shpenzimet për përkthime dhe përkthyes do të paguhen nga burimet buxhetore sipas tarifave të aplikueshme..

KERKESE PER KOMPENZIM

Nuk është parashtrua asnjë padi për kompensim. Prandaj, nuk është marrë asnjë vendim sipas Nenit 396 (4) KPPK.

Kryetari i Trupit Gjykes:

Procesmbajtës:

Gjyqtari i EULEX-it Jonathan Welford-Carroll

Zyrtarja Ligjore e EULEX-it
Zane Ratniece

Anëtarët e Trupit Gjykes:

Zyrtari Ligjor i EULEX-it Beti
Hohler

Shqipe Qerimi, Gjyqtare

Dean Pineles, Gjyqtar i
EULEX-it